



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.C.nr.5422/2018

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi, dhe Burim Shala, anëtarë të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditësit B.B. nga Komuna Gjakovë, të cilin e përfaqëson me autorizim XH.K. avokat me seli në Komuna Gjakovë, kundër të paditurës Posta e Kosovës Sh.A, me seli në Komuna Prishtinë, Dega në Gjakovë, të cilën e përfaqëson me autorizim F.E., jurist i diplomuar pranë Postës së Kosovës, në çështjen kontestimore për kompensimin e të ardhurave personale, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.208/2017 datë 19.09.2018, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 04.02.2021, mori këtë :

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit B.B. nga Komuna Gjakovë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.208/2017 datë 19.09.2018, **VËRTETOHET.**

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë, me aktgjykimin C.nr.208/2017 datë 19.09.2018, ndër të tjera ka vendosur si vijon : *“...I. REFUZOHET kërkesë-padia e paditësit B.B. nga Gjakova, përmes së cilës ka kërkuar që të “që të detyrohet e paditura Posta e Kosovës sh.a. me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, që paditësit B.B. nga Gjakova, që në emër të ndryshimit të koeficientit të lartësisë së të ardhurave personale nga grada 8 dhe grada 10 për periudhën kohore prej 01.03.2017 e deri në 30.06.2018, t’ia paguaj shumën prej 4,165.92 euro, si dhe shumën prej 568 euro në emër të shpenzimeve të procedurës, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë si dhe në të njëjtin afat dhe kërcënimin detyrohet e paditura që paditësit, duke filluar nga data 01.07.2018 e tutje t’ia paguaj të ardhurat personale në lartësinë e gradës 10” në tërësi si e pa bazuar. II. Secila palët i bartë shpenzimet e veta...”*

Kundër aktgjykimit C.nr.208/2017 datë 19.09.2018, të marrë nga Gjykata Themelore në Gjakovë, në afat ligjor i autorizuari i paditësit, ka paraqitur ankesë, për

shkak të : shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit që aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar apo që aktgjykimin e atakuar ta prishe dhe çështja ti kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë është paraqitur nga e paditura me propozim Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që ta refuzojë ankesën e paditësit si të pa bazuar dhe të vërtetoj aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë C.nr.208/17 datë 19.09.2018, si të ligjshëm dhe të drejtë.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.3/L-006 për Procedurën Kontestimore, e ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë brenda kufijve dhe shkaqeve të treguara në ankesë si dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore, gjeti se :

-Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi B.B. nga Komuna Gjakovë, ka paraqitur në gjykatën e shkallës së parë me datë 20.04.2017, kundër të paditurës Posta e Kosovës SH.A, me seli Komuna Prishtinë, Dega në Gjakovë, padi për kompensimin e të ardhurave personale.

Gjykata e shkallës së parë, e ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor dhe pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, dhe administrimit të provave, ka marrë aktgjykim C.nr.208/2017 datë 19.09.2018, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar gjykata e shkallës së parë ndër të tjera e ka arsyetuar se *“... nuk është provuar fakti se këtu e paditura Posta e Kosovës sh.a. Prishtinë te ketë detyrime në kompensimin e të ardhurave personale për paditësin B.B. nga Gjakova...Sipas nenit 10 të Ligjit të Punës (Ligji nr.03/L-2012) i cili parasheh që “kontrata e punës lidhen në formë të shkruar dhe nënshkruhet sipas nenit 11 të këtij ligji”...sipas nenit 55 par.1 i po të njëjtit ligj, i cili parasheh që “I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me kontratën e punës...”*

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimin, për arsye se aktgjykimin i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë procedurë kontestimore drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike, dhe atë nuk është kontestuese se palët ndërgjyqës me kontratën pune nr. 01-645/17 datë 03.07.2017, e kanë nënshkruar kontratën me datë 14.01.2015, dhe me këtë kontratë i kanë rregulluar të drejtat dhe detyrimet e tyre që dalin nga marrëdhënia e punës si vendin e punës, kohëzgjatjen e punës, gradën e pagesës dhe të drejtat tjera që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.

Në nenin 2 të Ligjit nr. 04/l-077 për marrëdhëniet e detyrimeve në mënyrë decidive thuhet se *“1. Pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve janë të lirë, që në pajtim me dispozitat urdhëruese, të rendit publik dhe të dokeve të mira, t'i rregullojnë marrëdhëniet e veta sipas vullnetit të tyre. 2. Pjesëmarrësit mund t'i rregullojnë marrëdhëniet e tyre të detyrimeve ndryshe nga ajo që është paraparë me këtë ligj, për derisa nuk rezulton diçka tjetër nga dispozitat e këtij ligji ose të kuptimit dhe qëllimit të tyre”*.

Ndërsa në nenin 15 të Ligjit nr. 04/l-077 për marrëdhëniet e detyrimeve në mënyrë decidive thuhet se *“Kontrata është e lidhur kur palët kontraktuese janë marrë vesh për elementet thelbësore të kontratës”*.

Pretendimi ankimor i paditësit se aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 181.1, dhe neni 182.1 pika (m), e Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pathemeltë, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i Aktgjykimit të atakuar është mjaft i kuartë, e në përputhje të plotë me arsyet e Aktgjykimit, Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për refuzimin e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, në përputhje të plotë me përmbajtjen e kërkuar me dispozitat e neni 160 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

Lidhur me pretendimet tjera ankimore të paditësit të parashtruara në ankesë, Gjykata e Apelit i mori parasysh dhe gjeti se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së neni 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AC.nr.5422/2018 datë 04.02.2021

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari,
Bujar Muzaqi